

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arhiva - Archive

Nr. i Prot. / No. Prot. / No. Prot. / 869-1/2022

Nr. i Doku / No. Doku / No. Doku / 13.05.2022

Nr. i Fajllit / No. Fajllit / No. Fajllit / 21

Nr. i Dokumentit / No. Dokumentit / No. Dokumentit / 22

PRISTINE/A



HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date / 16.05.2022

Nr. i Lëndës / No. Lëndës / No. Lëndës / -VI- 020-372/5

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Radu i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetari i Komunës së Drenasit
Kopje:	Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Elit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zytari hartues i vlerësimit ligjor: Elmedina Bajgora, Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor: Kimete Zekaj, Zytare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Shqyrtimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim



Reference:
068/2022

Inderuari Kryetar z. Lladrovi,

Inderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së

Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim Nr. 400/01-18363 për bartjen e mjeteve vetanake</i>
<i>I miratuar më datë 27.04.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.04.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 29.04.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Me anë të aktit administrativ komunal që është subjekt i shqyrtimit, Komuna e Drenasit ka synuar **bartjen e mjeteve financiare të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti paraprak në vitin aktual fiskal.**
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Udhëzimet Administrative Nr.04.2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale (këtej e tutje referuar si ‘Udhëzimet Administrative’).
3. Kështu, në kuptim të bartjes së bilanceve të pashpenzuara, neni 27 i LMFPP-së aludon se të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal skadojnë në fund të vitit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore **të cilat ndërlidhen me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunave.**
4. Konstatimi i mësipërm konkretizohet edhe më tej me nenin 9, paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, ku komunave u lejohej një bartje e bilanceve të pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2021 për vitin fiskal 2022.
5. Pra, procesi i bartjes së bilanceve të pashpenzuara ekziston si proces në fushëveprimin e legjislacionit të Ministrisë. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
6. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave iu mundësohet nxjerrja e vendimeve lidhur me bartjen e bilanceve të pashpenzuara, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo

nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë shkresë.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



02 Nr. 400/11-18363 dt. 27/04/2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), dhe nenit 34.pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, **27. 04.2022**, miratoi këtë:

VENDIM PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Më këtë vendim, miratohet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2020-2021 në vitin 2022. Mjetet për bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar.

Neni 2

Të hyrat vetanake të pa shpenzuara e që duhet të bartën janë në shumë prej: 1,165,018.04 € në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe shërbime	424,342.07 €
Subvencione dhe transfere	46,857.50 €
Investime kapitale	693,818.47 €

Neni 3

Shuma e mjeteve për bartje nga neni 2. i këtij Vendimi do të shpenzohet në këto kategori të shpenzimeve dhe në këto programe - nënprograme të komunës:

Mallra dhe Shërbime:

-Shërbimet e Shëndetësisë Primare (730) nën-programi (73100) dhe kod funksional (0721) në kategorinë mallra dhe shërbime (0130), në shumë prej:	29,195.17 €
- Arsimi Parafillor (920) nën-programi (92210) dhe kod funksional (0911) në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve (0130) në shumë prej:	37,299.94 €
-Drejtoria për Gjeodezi kadastrë dhe Pronë (650) nën-programi (65005) dhe kod funksional (0610) në kategorinë Mallra dhe Shërbime shuma prej	200,882.91 €
Drejtoria e administratës (163) nënprogrami (16301) dhe kod funksional (0133) në kategorinë mallra dhe shërbime shuma prej	155,000.00 €

-Planifikimi Urban dhe mbrojtje të mjedisit (663) nën-programi (66310) dhe kod funksional (0620) në kategorinë mallra dhe shërbime shuma prej..... 1,964.05 €

Gjithsej mallra dhe shërbime..... 424,342.07 €

Subvencione-transfere:

-Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje civile dhe Emergjencë (180) nën-programi(18001) dhe kod funksional (0451) në kategorinë e Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej.....31,404.20 €

-Drejtorati I Administratës Shëndetësi (730) nën-programi (73010) dhe kod funksional (0760) në kategorinë Subvencione dhe Transfere(200) në shumë prej:..... 11,253.01 €

-Drejtorati për kulturë rini dhe sport (850) nën-programi (85001) me kod funksional (0820) dhe shumë prej: 2,850.39 €

-Drejtorati I Administratës Arsim (920) nën-programi (92005) dhe kod funksional (0980) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) dhe në shumë prej: 1,349.90 €

Gjithsej Subvencione-transfere..... 46,857.50 €

Shpenzimet Kapitale:

Në programin Shërbimet Publike dhe punë Emergjente (180) nën-programi (18001) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese me kod projekti (49288) dhe shumë prej:..... 2,164.63 €

-Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të SHZSH Gllobar me kod të projektit (47884) dhe shumë prej 736.48 €

-Instalimi i ndriçimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriçimit me kod të projektit (49293) dhe shumë prej 16,571.54 €

Totali i Shërbimeve Publike dhe Punë Emergjente..... 19,472.65 €

Në Programin e Infrastrukturës Publike (181) nën-programi (18161) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Asfaltimi i rrugës Terrsteniku I dhe II me kod të projektit (48633) dhe shumë prej ... 10,102.00 €

-Asfaltimi i rrugës Baicë- Krajkov- Damanek me kod (48640) dhe shuma prej5,283.32 €

-Kanalizimi i ujërave të zeza Arllat, Negroc, Gjergjic me kod (48703) dhe shumë prej.3,703.90 €

-Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza me kod të projektit (48613) dhe shumë prej 100,000.00 €

-Rehabilitimi dhe rekonstruimi i rrugëve me kod të projektit (49188) dhe shuma prej256,062.31 €

-Rehabilitimi dhe rekonstruimi i kanalizimeve KK Drenas me kod të projektit (49189)) dhe shuma prej..... 100,000.00 €

-Rregullimi i infrastrukturës dhe ndriçimit publik KK Drenas me kod të projektit (48617) dhe shuma prej 75,000.00 €

-Ndërtimi i urave dhe tombinave me kod të projektit (49187) dhe shuma prej..... 50,000.00 €

Totali I infrastrukturës Publike në shumë prej 600,151.53 €

Në programin Shërbimeve Kadastrale dhe punë Gjeodezike (650) nën-programi(65005) dhe kod funksional (0610) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale

-Shpronësimet me kod të projektit (47969) dhe shuma prej 20,000.00 €

Totali Shërbimet katasrale dhe Punë Gjeodezike 20,000.00 €

Në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport (850) nën-programi (85001) dhe kod funksional (0820)do të bartën këto mjete:

-Renovimi i Objekteve Sportive me kod (49182) dhe shumë prej:..... 20,000.00 €

Totali I Kulturës, Rinisë dhe Sportit :.....20,000.00 €

Në programin e Administratës së Arsimit (920) nën-program (92005) do të bartën këto mjete

-Renovimi i Objekteve Shkollore me kod (49196) dhe shumë prej:.....34,194.29 €

Totali I Administratës se Arsimit 34,194.29 €

Neni 4

Për zbatimin e vendimit do të kujdeset: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe nënshkrimi i Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari